



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5451 prot.

Shkodër, më 7.3 . 2025

VENDIM

Nr. 14, datë 03.03.2025

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË TRAJTIMI STUDENTËVE SH.A
PËR TRANSFERIMIN E PASURIVE ME NR. 2/204, NR.2/699,ZK 8593 , PASURIVE ME
NR. 3/733, NR. 3/735 DHE NR.3/957 ZK 8591”.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 03.03.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.2 germa “a” dhe “c”, ligjin Nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM Nr. 350, datë 29.04.2020 “Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Trajtimi i studentëve” Sh.A Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Bashkia Shkodër”, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Vendimit Nr.1 “Për miratimin e statusit të “Trajtimi i Studentëve Sh.A”, shkresë së ASHK Nr.9 prot., datë 08.01.2025, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI :

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Trajtimi i Studentëve” Sh.A për transferimin e pasurive me Nr. 2/204; Nr.2/699, Zona Kadastrale 8593 si dhe pasurive me Nr. 3/733; Nr. 3/735 dhe Nr.3/957, Zona Kadastrale 8591 .
2. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionin në fuqi, nga Drejtoria Aseteve dhe Kadastres Urbane, pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Shkodër duke bashkërenduar punën me institucionet përgjegjëse .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 27 vota

Vota Pro	27
Vota Kundër	6
Vota Abstenim	2
Zbardhur me datë	04.03.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI

